



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.07.2016


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 88, të datës 15.06.2016, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 3, pika 3.5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (a), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin e vendimit Nr. 10, të datës 29.01.2014, lidhur me ndryshimin e përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Për ndryshimin e paragrafit një (1) të vendimit Nr. 10, të datës 29.01.2014 lidhur me përbërjen e anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa dhe zavendësimin e anëtarit z. Ylber Islami anëtar i pavarur i Kuvendit të Komunës, me znj. Trandolina Duli përfaqësuese e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje.
2. Zavendësimi i anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa bëhet duke u mbështetur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, nenin 13, paragrafi 3, pika 3.5.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave e Buxhetit dhe Udhëheqësi i Personelit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Drejtorisë së FB, Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 04.07.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 677, të datës 15.06.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave me përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, në debatin publik të caktuara për datën: 15.06.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.




**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. sc. Fadil Krasniqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.06.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 604, të datës 13.06.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019, me kufijt e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2017 buxheti i komunës është në shumë prej: 9,540,837.00€;
 - 1.2 Për vitin 2018 buxheti i komunës është në shumë prej: 9,726,342.00€;
 - 1.3 Për vitin 2019 buxheti i komunës është në shumë prej: 9,910,117.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB dhe Arkivës.**

